

## **Pasi të aplikoni për strehim të përballueshëm: Lista dhe Burime**

---

*NYC Housing Connect*

*[PAGE 1]*

### **RRETH KËTIJ UDHËZUESI**

Aplikimet për strehim të përballueshëm përzgjidhen me short për shqyrtim.

Nëse numri juaj përzgjidhet nga shorti, dhe nëse aplikimi juaj rezulton i pranueshëm, ju do të ftoheni për të caktuar një takim ku do të konfirmohet kualifikueshmëria juaj. Në takim do shqyrtohet dokumentacioni i paraqitur në mbështetje të informacionit që ju keni dhënë në aplikimin tuaj.

Zakonisht takimet caktohen nga dy deri në dhjetë muaj pas përfundimit të afatit të aplikimit. Do t'ju duhet të sillni me vete dokumente për personat që do të jetojnë me ju, sa fitojnë ata me të cilët ju do të jetoni, apartamentin tuaj aktual dhe informacione të tjera.

Ky udhëzues ju ndihmon të përgatiteni për takimin. Këtu listohen dokumentet që mund t'ju duhet të sillni me vete dhe jepen këshilla se si të gjeni dhe të përgatisni kopjet që ju duhen.

[PAGE 2]

## **DOKUMENTET E FAMILJES**

Nëse kontaktoheni për një takim konfirmues të kualifikueshmërisë suaj, do t'ju kërkohet të sillni me vete KOPJE të dokumenteve që vërtetojnë pjesëtarët e familjes suaj. Ju lutemi, mos sillni dokumente origjinale, nëse kjo nuk ju kërkohet. Kopjet e këtyre dokumenteve do të arkivohen - ju nuk do t'i merrni prapa ato.

Personi i autorizuar do t'ju informojë se cilat dokumente duhet të sillni me vete. Mund të kërkohen të gjitha aktet e mëposhtme.

## **A I KENI KËTO DOKUMENTE?**

### **Apartamenti aktual**

- Kopje e kontratës suaj aktuale të qirasë, nëse keni apartament me qira. Nëse nuk keni kontratë qiraje, një letër të noterizuar nga qiradhënësi juaj.
- Kopje të mandatpagesave të qirasë të tre (3) deri dymbëdhjetë (12) muajve të fundit ose çeqet e arkëtuara të qirasë.
- Kopje të mandatpagesave më të fundit të energjisë elektrike dhe gazit (në emrin tuaj dhe që tregojnë adresën tuaj aktuale).
- Fotokopje të mandatpagesës më të fundit të telefonit (në emrin tuaj dhe që tregon adresën tuaj aktuale).
- Nëse nuk paguani qira dhe jeni duke jetuar me dikë tjetër, sillni me vete një vërtetim të noterizuar nga bashkëbanuesi juaj së bashku me një kopje të kontratës së tij/saj dhe kopje të faturave të tij/saj të shërbimeve.

### ***Ku mund t'i noterizoj dokumentet?***

- Agjentët e administrimit të pronave dhe zyrat lokale ligjore ose të taksave zakonisht kanë noterë në stafin e tyre.
- Pjesa më e madhe e bankave mund të noterizojë dokumentet me tarifa simbolike.

### **Pjesëtarët e Familjes**

- Kopje të certifikatave të lindjes për çdo person të familjes
- Kopje të kartave të sigurimeve shoqërore për çdo person të familjes
- Kopje të dokumentit të identifikimit me fotografi për gjithë personat mbi 18 vjeç (shembuj: leja e drejtimit, pasaporta, dokument identifikimi ushtarak, dokument identifikimi i Bashkisë së Nju-Jorkut, dokument identifikimi për jo drejtuesit e automjetit)
- Kopje të letrave të shkollës që vërtetojnë regjistrimin e të gjithë atyre që ndjekin shkollën (shembuj: shkollë publike e Nju-Jorkut, shkollë private, universitet)

[PAGE 3]

## ***Si mund t'i marr dokumentet e identifikimit?***

### **CERTIFIKATË LINDJEJE**

Koha e përgatitjes: 2 ditë deri në 8 javë | Kosto: 15\$–25\$

- Lindjet në Qytetin e Nju-Jorkut: Kopje të certifikatave zyrtare të lindjes së Qytetit të Nju-Jorkut mund të porositen në internet, personalisht, ose nëpërmjet postës përmes Departamentit të Shëndetit dhe të Higjienës Mendore të Qytetit të Nju-Jorkut (NYC Department of Health and Mental Hygiene). Ato kushtojnë 15\$, plus një tarifë postimi dhe shërbimi prej 9\$. Porositë në internet përpunohen brenda 24 orëve. Vizitoni <http://www.nyc.gov/doh> ose telefononi 311 për detaje të mëtejshme.
- Lindjet në vende të tjera të Shteteve të Bashkuara: Certifikatat mund të kërkohen zakonisht pranë sekretarive gjyqësore ose pranë zyrave të gjendjes civile. Për të gjetur zyrën e gjendjes civile të shtetit tuaj, ju lutemi, vizitoni <http://www.cdc.gov/nchs/w2w.htm> ose kërkoni ndihmë në bibliotekën tuaj rajonale.

### **KARTA E SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Koha e përgatitjes: 2 deri në 6 javë | Kosto: Falas

- Tërhiqni aplikimin nga zyra rajonale e Sigurimeve Shoqërore dhe/ose Qendra e Kartave. Për të gjetur zyrën tuaj rajonale, telefononi 1-800-772-1213 ose vizitoni <http://www.ssa.gov/cardcenters/cardcenterinfo.html>.

## **LEJA E DREJTIMIT OSE DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT ME FOTO I DREJTUESVE TË MJETEVE TË NJU-JORKUT**

Koha e përgatitjes: 2 deri në 4 javë | Kosto: 10\$–80\$

- Aplikoni pranë Departamentit të Shtetit të Nju-Jorkut për Mjetet Motorike (NY State Department of Motor Vehicles) për të marrë një leje drejtimi ose një dokument identifikimi me foto për jo-drejtnes. Vizitoni [www.dmv.ny.gov/license.html](http://www.dmv.ny.gov/license.html) për më shumë detaje, gjeni degën tuaj rajonale duke vizituar <http://www.dmv.ny.gov/offices.htm>, ose telefononi 1-212-645-5550 ose 1-718-966-6155 për informacion.

## **IDNYC: DOKUMENT IDENTIFIKIMI I BASHKISË SË QYTETIT TË NJU-JORKUT**

IDNYC (Dokumenti i identifikimit i qytetit të Nju-Jorkut) është karta e identitetit falas për gjithë banorët e qytetit të Nju-Jorkut. Vizitoni [www.nyc.gov/idnyc](http://www.nyc.gov/idnyc) për të nisur plotësimin e aplikimit online, ose telefononi 311.

### ***Ku mund të bëj fotokopje?***

- Biblioteka Publike e Bruklinit: Telefononi 311 ose vizitoni [www.brooklynpubliclibrary.org](http://www.brooklynpubliclibrary.org)
- Biblioteka Publike e Nju-Jorkut: Telefononi 311 ose vizitoni te [www.nypl.org](http://www.nypl.org) për degët në Bronx, Manhattan dhe Staten Island
- Biblioteka Publike e Kuinsit: Telefononi 311 ose vizitoni [www.queenslibrary.org](http://www.queenslibrary.org)
- Zyra juaj rajonale e bordit komunitar: Telefononi 311
- Dyqane fotokopjesh dhe printimesh

[PAGE 4]

## **DOKUMENTET E TË ARDHURAVE**

Të ardhurat vjetore të familjes suaj janë "shuma bruto" që fiton secili person mbi 18 vjeç që banon me ju. "Shuma bruto" nënkupton atë që ju është paguar nga punëdhënësi juaj para zbritjes së taksave. Të ardhurat tuaja bruto janë zakonisht më tepër nga paga që çoni në shtëpi. (Shënim: Nëse jeni i/e vetë punësuar, do të raportoni të ardhurat tuaja neto pas zbritjes së taksave.)

Mblidhni sa më shumë dokumente që të keni mundësi. Sipas IRS (Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme) dokumentet e mëposhtme janë prova të pranueshme për të ardhurat. Paraqisni dokumente për të ardhurat e çdo pjesëtari të familjes mbi 18 vjeç.

### **A I KENI KËTO DOKUMENTE?**

#### ***Pse janë të nevojshme gjithë këto dokumente?***

HPD (Departamenti i Ruajtjes dhe Zhvillimit të Strehimit) dhe HDC (Korporata e Zhvillimit të Strehimit) i kërkon gjithë këto dokumente për të konfirmuar dhe llogaritur shumën totale vjetore që fiton familja juaj - nga punësimi i rregullt dhe nga burime të tjera të ardhurash.

#### **Të ardhurat nga Punësimi i Familjes**

#### ***A merr ndonjë pjesëtar i familjes suaj rrogë mujore apo pagesë për orë pune?***

Zhvilluesi do t'ju tregojë se cilat dokumente kërkohen.

Zakonisht ju kërkohet të paraqisni dokumentet e mëposhtme për secilin pjesëtar të familjes:

- Kopje të gjashtë (6) kuponave të fundit që detajojnë pagën

- Kopje të formularëve W-2 (Deklarata e Pagës dhe e Taksave) të vitit të fundit (të gjitha faqet)
- Kopje të deklaratave të plotësuara dhe të nënshkruara të taksave shtetërore dhe federale të vitit të fundit
- Vërtetime të pagesave me para në dorë (vërtetim I noterizuar i punëdhënësit)
- Pasqyra të llogarisë bankare që vërtetojnë depozitat

***A është ndonjë pjesëtar i familjes suaj i/e vetëpunësuar?***

Për çdo pjesëtar të vetëpunësuar në familje, paraqisni kopje të:

- Kopje të nënshkruara të Formularit 1040 (Deklarata e Taksave për të Ardhurat Individuale e SHBA) të 3 viteve të fundit, me shtojcat C, E ose F
- Kopje të të gjithë formularëve 1099 të 3 viteve të fundit
- Kopje të deklarimeve të taksave të 3 viteve

*[PAGE 5]*

**Të ardhurat familjare nga burime të tjera**

Ju duhet të paraqisni dokumente për të gjitha të ardhurat që keni, edhe nëse nuk vijnë nga punësimi. Zhvilluesi do t'ju tregojë se cilat dokumente kërkohen. Zakonisht ju kërkohet të paraqisni dokumentet e mëposhtme për secilin pjesëtar të familjes:

***A merrni përfitimet ose të ardhurat listuar më poshtë?***

Kopje të dokumentacionit për:

- Vërtetim(e) të përfitimeve nga Sigurimet Shoqërore për vitin e fundit kalendarik (të lëshuara jo më shumë se 30 ditë para)
- Përfitime nga statusi i veteranit (dokumentacion vjetor)
- Të ardhura nga prona të dhëna me qira

- Vërtetim të Buxhetit të Asistencës Publike Rezerva të Forcave të Armatosura

***A merrni dividendë dhe/ose pensione vjetore?***

- Kopje të deklaratave nga institucioni(et) lëshues(e)

***A merrni bursa studimi dhe/ose grante?***

- Kopje të datuara të vërtetimeve të ndihmave financiare

***A merrni ndihma ushqimore dhe/ose përkrahje financiare për fëmijën?***

Paraqisni kopje të:

- Kopje të marrëveshjes(ve) të zgjidhjes së martesës që deklarojnë shumën dhe llojin e mbështetjes dhe kohën e pagesës
- Kopje të çdo deklarate zyrtare ose të printuar (datuar brenda 120 ditëve të fundit dhe që tregon aktivitetin dhe shumat), ose deklaram përpara noterit.

***Sigurimi për aftësi të kufizuar, dëmshpërblimi i punëtorëve, dhe/ose pagesat për vjetërsi?***

- Kopje të gjashtë (6) muajve të fundit të kuponave që detajojnë pagën ose një vërtetim page

***A merrni kontribute të përsëritura dhe/ose dhurata? A merrni forma të tjera të ardhurash periodike?***

- Deklaratë e noterizuar dhe/ose vetëdeklarim përpara noterit e nënshkruar nga personi që jep ndihmën, përfshirë qëllimin e të ardhurave, datat dhe vlerën e dhuratës(ve), dhe sa shpesh jepet dhurata (çdo javë, çdo muaj, çdo vit).
- Deklarata bankare që vërtetojnë marrjen e këtyre pagesave



## **PROBLEME TË KUALIFIKUESHMËRISË**

Ju duhet të dokumentoni çdo problem që keni pasur me qiradhënësit tuaj të mëparshëm ose me kreditin tuaj. Edhe me këto dokumente, nuk ka garanci që ju do të kualifikoheni për të marrë një apartament. Aplikimi juaj mund të refuzohet, pavarësisht dokumentacionit të plotë.

### **Probleme të mëparshme me qiradhënësin**

***A ka ndërmarrë një qiradhënës veprim ligjor ndaj jush për ndonjë arsye?***

Nëse po, sillni kopje të:

- Të gjithë marrëveshjeve ligjore
- Çdo vendim gjyqësor të formës së prerë
- Vërtetimeve për shlyerje të detyrimeve të depozituara në gjykatë

### **Problemeve të mëparshme me kreditin**

***Si është historiku juaj i kreditit?***

Nëse përzgjidheni për një takim konfirmimi të kualifikueshmërisë, krediti juaj mund të jetë një faktor në procesin vendimmarrës.

Ju nuk mund të shkualifikoheni duke u bazuar vetëm te pikët tuaja të kreditit, por informacioni për historikun tuaj të kreditit është i rëndësishëm. Nëse keni ndonjë dokument për kreditin tuaj, ju këshillojmë ta siguronit paraprakisht. Për shembull:

- Korrespondencë që tregon zgjidhjen e problemeve të kreditit ose të borxheve
- Pagesa e garancive ose vendimeve gjyqësore

- Gjendja e llogarisë rrjedhëse
- Çdo vendim gjyqësor të formës së prerë

Ju lutemi, kini parasysh që dhënia e këtij informacioni nuk garanton që ju do të kualifikoheni për të marrë një apartament.

Për të marrë një kopje falas të raportit të kreditit tuaj vizitoni [www.annualcreditreport.gov](http://www.annualcreditreport.gov).

Për të marrë shërbimet e fuqizimit financiar për njujorkezët, telefononi 311 ose vizitoni [nyc.gov/consumers](http://nyc.gov/consumers).

Vizitoni [www.nyc.gov/housingconnect](http://www.nyc.gov/housingconnect) për më shumë informacion ose për të aplikuar online.

*[FOOTER]*

NYC Housing Connect

Gjeni dhe aplikoni për strehim të përballeshëm

New York City Department of Housing Preservation and Development

New York City Housing and Development Corporation

Facebook: [www.facebook.com/NYCHPD](http://www.facebook.com/NYCHPD)

Twitter: @nychousing

Faqja zyrtare e internetit: [www.nyc.gov/hpd](http://www.nyc.gov/hpd)

Vizitoni [www.nyc.gov/housingconnect](http://www.nyc.gov/housingconnect) për më shumë informacione rreth mënyrës së aplikimit online.

Ky dokument është vetëm me natyrë informuese. Ky nuk është një aplikim për strehim të përballeshëm. Plotësimi i këtij dokumenti nuk ju garanton se do të përfitoni një njësi

banimi të përballueshme.